

**KONTRATË**  
**SHIT – BLERJE AKSIONESH**

Sot, më datë 29.10.2021, lidhet kjo kontratë Shit – Blerje Aksionesh me termat e mëposhtme:

**SHITËSI :** **Fuad Haxhiymeri**, shtetas shqiptar, i biri i Hajredin, i datelindjes 28.01.1964 ne Tirane, banues ne Tirane, lidentifikuar me pasaporten me Nr.BB5971482 të pasaportes me nr. personal G40128172R, madhor e me zotesi të plote juridike per te vepruar;  
(këtu e më poshtë në këtë kontratë do të quhet **Shitesi**)

**BLERËSIT :** **Arjan Hana**, i biri i Astritit, i datelindjes 11.06.1979, lindur dhe banues ne Tirane, idnetifikuar me karten e identitetit Nr. 025799686, madhor e me zotesi të plote juridike per te vepruar;  
(këtu e më poshtë në këtë kontratë do të quhet **Bleresi**)

**OBJEKTI:** Shitja e aksioneve të shoqërisë “SCAN” sh.a. në masën 9,28% të kapitalit themeltar, aksione këto që zotërohen nga aksioneri i shoqërisë Z. Fuad HAXHIYMERI, me cilësinë e shitësit, dhe blerja e tyre nga Z. Arjan Hana, me cilësinë e blerësit.


**PËRMBAJTA E KONTRATËS**

Shoqëria tregtare “SCAN” Sh.a., person juridik i se drejtes shqiptare eshte regjistruar në Regjistrin Tregtar ne baze te vendimit Nr. 23760, date 09.05.2000 të Gjykatës së Rrethit Rrethit Gjyqesor, Tirane dhe ka numer NIPT K12312001A. Shoqëria është themeluar me një kapital fillestar ne momentin e regjistrimit prej 2.000.000 lekë.

Me vendimin e datës \_\_\_\_\_.2021 të Keshillit Mbikqyres dhe të dates 28.10.2021 të Asamblese se Aksionereve të kesaj shoqërie është vendosur te miratohet transferimi nepermjet shitjes së paketes prej 400,000 aksioneve me të drejte vote në masën 9,28% të tyre nga ana e aksionerit të shoqërisë, z. Fuad Haxhiymeri dhe blerja e tyre nga ana e Z. Arjan Hana.

Shitja e paketës prej 9,28% të aksioneve të kapitalit themeltar të Shoqërisë “SCAN” Sh.a. sjell humbjen e së drejtës së pronësisë mbi keto aksione nga e aksionerit, Z. Fuad Haxhiymeri, si pasojë e këtij transaksioni shitjeje, shprehur kjo në vendimin e mësipërm të Asamblese se Pergjithshme dhe të Keshillit Mbikqyres.

Shitësi, Fuad Haxhiymeri është plotësisht dakort të shesë me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë 9,28% të aksioneve që ai zotëron në shoqërinë “SCAN” Sh.a. Kjo shitje aksionesh, sipas kësaj kontrate do të bëhet në favor të blerësit, Z. Arjan Hana.



Blerësi, Z. Arjan Hana është plotësisht dakort që të blej me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë, 9,28% të aksioneve të zotëruara nga shitësi në kapitalin themeltar të shoqërisë tregtare "SCAN" Sh.a.

### **MËNYRA E KALIMIT TË PRONËSISË SË AKSIONEVE**

Me nënshkrimin e kësaj kontrate, shitësi, aksionari Z. Fuad Haxhiymeri humbet pronësinë mbi 9,28% të aksioneve të zotëruara prej tij në kapitalin themeltar të shoqërisë "SCAN" Sh.a., duke mos patur në të ardhmen asnjë pretendim pronësie mbi aksionet që shiten në bazë të kësaj kontrate.

Pas nënshkrimit të kësaj kontrate dhe regjistrimit të kësaj kontrate në Qendren Kombetare të Regjistrimit, shitësi humbet cilësinë e aksionerit të shoqërisë "SCAN" sh.a. Blerësi, Z. Arjan Hana në masën 9,28% bëhet pronar me të gjitha të drejtat dhe detyrimet përkatëse mbi paketen prej 400,000 aksioneve me të drejte vote apo 9,28% të aksioneve të shoqërisë "SCAN" sh.a., duke marrë cilësinë e aksionereve të shoqërisë.

### **ÇMIMI I SHITJES SË AKSIONEVE**

Si çmim i këtij transaksioni shit – blerje aksionesh të shoqërisë "SCAN" Sh.a. do të jetë shuma prej 2,400,000 lekë.

Sipas këtij përcaktimi, Blerësit paguajnë në favor të Shitësit Z. Fuad Haxhiymeri, shumë e cila është paguar jashtë kësaj zyre dhe shitësi nuk do të ketë sot dhe në të ardhmen pretendime për këtë shumë apo për çdo shumë tjetër.


### **DISPOZITA TË FUNDIT**

Kontrata hartohet në 4 (kater) kopje të njëjta nga të cilat një e mbajnë palët, një kopje depozitohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar pranë Qendres Kombetare të Regjistrimit, një kopje depozitohet në aktet e shoqërisë. Palët nënshkruan kontratën me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë.

### **PALËT**

**SHITËSI**

**Fuad HAXHIYMERI**



**BLERËSI**

**Arjan HANA**

